



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
REKTORI

Nr. 1519/1 Prot.

Tiranë, më 16.06.2026

URDHËR

Nr. 50, datë 16.06.2026

“PËR

**MIRATIMIN E KRITEREVE PËR EKSPERTËT E JASHTËM QË DO TË  
ANGAZHOHEN NË PROCESIN E PIKËZIMIT DHE RENDITJES SË  
APLIKANTËVE NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, VITI AKADEMIK  
2026-2027”**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin dhe Rregulloren e UMT-së, Urdhrin e Rektorit të UMT-së nr. 47, datë 08.06.2026 “Për ngritjen e komisionit të monitorimit dhe grupit teknik të punës për pranimet e kandidatëve që aplikojnë në programet e ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2026-2027” si dhe në shkresën e Drejtorisë së Administrimit Akademik dhe Kurrikulës me nr. 1519 prot, datë 11.06.2026 “Propozim për kriteret për ekspert të jashtëm që do të angazhohen për procesin e pikëzimit dhe renditjes të aplikantëve në kuadër të pranimeve në programet e ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë në UMT, viti akademik 2026-2027.”;

URDHËROJ:

**I. Miratimin e kriterëve dhe fillimin e procedurës së punësimit për ekspertët e jashtëm që do të angazhohen në procesin e përllogaritjes së pikëve dhe renditjes së aplikantëve në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2026-2027, si më poshtë:**

**A. Kriteret për ekspert i programimit (1 vend):**

1. Të ketë përfunduar studimet e larta në fushën e shkencave informatike ose të aplikuara;
2. Të njohë Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
3. Të njohë kurrikulën e re dhe të vjetër të arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë;
4. Të ketë eksperiencë në përllogaritjen e pikëve të kandidatëve që kanë aplikuar në institucionet e arsimit të lartë;
5. Të ketë njohuri të avancuara në fushën e programimit.

**B. Kriteret për ekspert në përpunimin e të dhënave excel i avancuar (1 vend):**

1. Të ketë përfunduar studimet e larta në fushën e shkencave informatike ose të aplikuara;
2. Të njohë Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
3. Të njohë kurrikulën e re dhe të vjetër të arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë;

4. Të ketë eksperiencë në përllogaritjen e pikëve të kandidatëve që kanë aplikuar në institucionet e arsimit të lartë;
5. Të ketë njohuri të avancuara të programit Excel, në përdorimin e funksioneve të kërkimit, funksioneve logjike dhe të përputhjes (Match/Vlookup/index) si dhe gjenerimit të raporteve PIVOT.

### **C. Dokumentacioni i kërkuar:**

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass) i përditësuar;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe njehsimin e tyre në MA (për diplomat e marra jashtë vendit), bashkë me listën e notave të noterizuara (për secilin program përkatës studimi);
5. Dokument që vërteton eksperiencën në përllogaritjen e pikëve si edhe të programeve sipas pikave 4 dhe 5 të kriterëve të përcaktuara në pikën A dhe B.

### **D. Dorëzimi i dokumentacionit dhe afati i dorëzimit :**

Kandidatët e interesuar, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar të inventarizuar, original ose të njësuar me origjinalin, pranë zyrës së Protokoll Arkivës, në Rektoratin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë ose nëpërmjet postës në adresën: Rruga e Dibrës, Nr.371, 1005, Tiranë

Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët do të jetë nga data 17.06.2026 deri më datë 23.06.2026.

### **E. Mënyra e vlerësimit:**

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje.

**II.** Ngarkohet Drejtorja e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij urdhri si dhe Drejtorja e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit për publikimin në faqen zyrtare të UMT-së.

*Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.*

**REKTORI**  
**PROF. DR. XHELADIN DRAÇINI**

